



Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



Në bazë të paragrafit 6 të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 si dhe nenit 63 paragrafi 63.1. pika (a) lidhur me paragrafin 63.1.2 të Rregullores 01/2022 për Prokurimin Publik, lidhur me kërkesën për rishqyrtim të datës 26.07.2024 të paraqitur nga Operatori Ekonomik: N.T.P. “Gresa-Commerce nga Pirana bie këtë :

VENDIM

I. Refuzohet **si e pa bazuar** kërkesa për rishqyrtim e Operatorit Ekonomik N.T.P. “Gresa-Commerce nga Pirana e parashtruar në mënyrë elektronike përmes platformës së prokurimit me datën 26.07.2024 për aktivitetin e prokurimit me numër: 626-24-5702-1-2-1 dhe nr. të brendshëm: 626-24-011-1-2-1 me titull: “FURNIZIMI ME DRU DHE PELET PËR NGROHJE”

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij.

ARSYETIM

Operatori ekonomik N.T.P. “Gresa-Commerce nga Pirana me datë 26.07.2024 përmes platformës elektronike të prokurimit, ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim të vendimit për dhënie të kontratës nga Autoriteti Kontraktues Komuna e Maushës për procedurën e prokurimit me titull: “FURNIZIMI ME DRU DHE PELET PËR NGROHJE”

Si autoritet kontraktues pas pranimit të kërkesës për rishqyrtim, menjëherë kemi bërë pezullimin e kësaj procedure dhe brenda afatit ligjor me kujdes të shtuar, kemi shqyrtuar të gjitha pretendimet ankimore të paraqitura në kërkesën për rishqyrtim të vendimit.

Në pretendimet e O.E. është cekur se janë bërë shkelje të neneve 1; 6; 7; 59; 60; 69 dhe 72 të LPP-s. Konsiderojmë që të gjitha këto pretendime të shkeljes së LPP-s, janë të pa baza dhe të pa vërteta për arsyet e cekura në vijim:

Në pretendimin e parë të paraqitur në kërkesën për rishqyrtim nga ana e operatorit ekonomik ankues, është cekur se: ju sqarojmë se arsyeja për eliminimin tonë është e paqëndrueshme për faktin se kërkesa në lidhje me afatin e liferimit në këtë fazë është e panevojshme. Afati i liferimit përcaktohet në momentin e nënshkrimit të kontratës, pra OE në momentin e nënshkrimit të kontratës e pranon edhe afatin e liferimit të cilin e përcakton autoriteti kontraktues, andaj në këtë rast ne nuk mund dhe nuk duhet të eliminohejmë më këtë arsye të eliminimit.

Gjithashtu në rast se autoriteti kontraktues ka pasur dilema në lidhje me çështjen e afatit të liferimit, atëherë e njëjta ka mundur të kërkojë sqarime shtesë dhe ne do të kishim sqaruar dhe deklaruar që afati i liferimit është 15 ditë ashtu siç është përcaktuar në dosje të tenderit.

Në këtë rast mos prezantimi i deklaratës për afatin e liferimit duhet të cilësohet si devijim i vogël sipas dispozitave të nenit 59.4 të LPP-së ku është specifikuar “

4. Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është 4/10 në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmjja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve”.

Pra përderisa deklarata për afatin e liferimit nuk përbën ndonjë ndryshim material dhe kur kemi parasysh faktin se në këtë aktivitet të prokurimit ne kemi ofertuar me çmim më të lirë se sa OE i rekomanduar për kontratë për 13,765.00 euro, atëherë mos prezantimi i deklaratës për afat të liferimit duhet të konsiderohet si devijim i vogël.

Duke u bazuar në të gjitha dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë konstatojmë se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së, sepse është rekomanduar për kontratë OE i përgjegjshëm.

Në dosje të tenderit në nenin 5.3 dhe në njoftimin për kontratë në nenin III.1.3 është kërkuar që:

-Operatorët ekonomik pjesëmarrës në këtë tender janë të obliguar që të hartojnë afatin e liferimit.

-Afati i liferimit nuk duhet të jetë më i gjatë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga data e porosisë.

Në rast të mos përmbushjes së këtij kushti O.E. do të konsiderohet si i pa përgjegjshëm, oferta do të refuzohet dhe do të qojë në eliminimin e operatorit ekonomik.

Pra sikur shihet më lartë, kërkesa administrative ka qenë kërkesë shumë e qartë dhe është kërkuar nga O.E. pjesëmarrës që të japin afatin e liferimit. Kjo kërkesë nuk mund të bëhet në momentin e nënshkrimit të kontratës sikur është pretenduar në kërkesën për rishqyrtim pasi që O.E. mund të mos pranojë të nënshkruaj kontratën dhe procedura duhet të anulohet në tërësi. Legjislacioni i prokurimit kërkon që të gjitha kriteret dhe kushtet të përcaktohen në fazën e tenderimit dhe jo në momentin e nënshkrimit të kontratës.

Sa i përket çështjes së kërkesës për sqarimin e tenderit ne me datën 08.07.2024 duke u bazuar në nenin 72 të LPP-s kemi kërkuar nga ana e O.E. sqarim për të gjitha dokumentet tjera që janë kërkuar në dosje të tenderit dhe njoftimin për kontratë e të cilat nuk janë dorëzuar me tenderin tuaj, mirëpo në paragrafin 3 të nenit 72 në mënyrë të qartë është paraparë që: “Sigurimi i informacionit që mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive. Duhet të theksojmë që afati i liferimit ka qenë kusht administrativ dhe nuk është dokument ekzistenca e të cilit është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve dhe nuk mund të verifikohet në mënyrë objektive. Gjithashtu nuk mund të konsiderohet si devijim i vogël pasi që kushtet administrative janë kushte të detyrueshme dhe mosplotësimi i tyre qon në eliminimin e operatorëve ekonomik si të pa përgjegjshëm. Andaj, konsiderojmë që ky pretendim është i pa bazë.

Më tej O.E. ankues pretendon që janë shkelur edhe dispozitat e nenit 60 të LPP-s për shkak që sipas O.E. ankues, nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët siç parashihet edhe në nenin 60 paragrafi 1.1 i LPP-së, por me qenë se O.E. ankues ka paraqitur tender të pa përgjegjshëm edhe pse ka ofruar çmimin më të ulët nuk mund të shpërblehet me kontratë. Edhe pretendimi që është shkelur neni 59 i LPP-s është i pa bazë pasi që komisioni i vlerësimit gjatë vlerësimit të tenderit i ka respektuar me përpikëri të gjitha dispozitat e këtij neni. Në bazë të nenit 40 paragrafi 40.6 të Rregullores 01/2022 për Prokurimin

Publik është paraparë që: Tenderi do të konsiderohet i përgjegjshëm kur: a. është në pajtueshmëri nga aspekti administrativ me kërkesat formale të dosjes së tenderit; b. është në pajtueshmëri në termet teknike me përshkrimin, kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në dosje të tenderit; c. është dorëzuar nga Operatori ekonomik që përmbush kriteret e përzgjedhjes të përcaktuara në dosje të tenderit. Pra vetëm tenderët që i plotësojnë të gjitha kërkesat dhe kriteret e dosjes së tenderit të cilët konsiderohen të përgjegjshëm mund të shpërblehen me kontratë.

Sa i përket pretendimit se janë shkelur dispozitat e nenit 7 të LPP-së, konsiderojmë që edhe ky pretendim është i pa bazë pasi që ne, të gjithë pjesëmarrësit i kemi trajtuar në mënyrë të barabartë pa kurrfarë diskriminimi kemi zbatuar procedurën e hapur për prokurimin në fjalë të cilën e kemi udhëhequr në mënyrë transparente dhe jo diskriminuese, në përputhje të plotë me legjislacionin e prokurimit në fuqi. O.E. ankues ka kërkuar qasje në dokumentet e tenderit në fjalë dhe ne kemi qenë transparent duke ia ofruar qasjen e pa penguar dhe në kohën më të shpejtë të mundur, për të gjitha dokumentet të cilat i ka kërkuar. Nga procesverbali i qasjes në dokumentacionin e këtij tenderi shihet se përfaqësuesi i O.E. ankues, nuk ka pasur asnjë vërejtje në lidhje me qasjen, gjithashtu të gjitha dokumentet e procedurës janë ngarkuar në platformën e-prokurimi dhe në ueb-faqe të Komunës së Mamushës, andaj është për tu habitur pretendimi i O.E. ankues se procedura nuk është zhvilluar në mënyrë transparente. Sikur është cekur më lartë ne përmes letrës standarde kemi kërkuar sqarim për të gjitha dokumentet tjera për të cilat është e lejuar me legjislacionin e prokurimit që të kërkohej sqarim. Gjithashtu O.E. ankues ka pasur mundësi të kërkojë sqarim në lidhje me kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimin për kontratë nëse nuk e ka pasur të qartë ndonjë kërkesë të paraqitur në dosje të tenderit apo njoftimin për kontratë, mirëpo nuk ka paraqitur një kërkesë të tillë.

Operatori Ekonomik ankues ka pretenduar se janë shkelur edhe dispozitat e nenit 1 të LPP-së. Edhe ky pretendim është i pa qëndrueshëm, pasi që ne si Autoritet Kontraktues i kemi respektuar të gjitha dispozitat ligjore të legjislacionit të Prokurimit Publik. Shkelja e këtij nenin do të vinte në shprehje po të kishte dorëzuar tender të përgjegjshëm O.E. ankues, mirëpo për shkak se nuk i ka plotësuar kërkesat e cekura më lartë është konsideruar si i pa përgjegjshëm.

Sa i përket dëmeve materiale për të cilat O.E. pretendon se i janë shkaktuar dëme për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës dhe për kërkesën për rishqyrtim në vlerë prej 5,000.00 €, në dosje të tenderit shprehimisht është cekur se AK nuk i mbulon shpenzimet të cilat i bëjnë tenderuesit me rastin e përgatitjes dhe dorëzimit të tenderit të tyre. Pra edhe ky pretendim është i pa bazuar.

Andaj,

Duke u bazuar në atë që u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Mamushë, me dt 29.07.2024

Gazmend Gashi
Udhëheqësi i sektorit të prokurimit
Komuna e Mamushës

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të parashtroj ankesë pranë **Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP)** brenda afatit prej 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.